



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2153, datë 14.09.2012

Për

“Miratimin e publikimit të raportit të AKEP për Këshillimin Publik të realizuar dhe propozimeve për Këshillin e Ministrave “ Për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Enkeleda Bega, në mbledhjen e datës 14.09.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e publikimit të raportit të AKEP për Këshillimin Publik të realizuar dhe propozimeve për Këshillin e Ministrave “ Për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””

B A Z A L I G J O R E:

1. Neni 78, 86, 110 si dhe shkronja c) dhe ç) të pikës 1 si dhe pika 2 të nenit 119 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr.9918*);
2. Pikat 12 dhe 17 të nenit 21 dhe shkronja f) pika 3 e nenit 23 e “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendëshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
3. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik” miratuar me Vendim nr. 1183, datë 10.03.2010, të Këshillit Drejtues të AKEP;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Informacioni mbi zhvillimin e Këshillimit Publik;
- Raporti i AKEP mbi Këshillimin Publik të realizuar;
- Projekt Vendimi i Këshillit Drejtues mbi “Miratimin e publikimit të raportit të AKEP për Këshillimin Publik të realizuar dhe propozimeve për Këshillin e Ministrave “ Për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””;
- Projekt Vendimit për Këshill të Ministrave ” Për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike” dhe Relacionin shoqërues;
- si dhe, duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

1. Materiali i përgatitur për publikimin e raportit të AKEP mbi këshillimin publik të realizuar për dokumentin “Mbi propozimin për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””, me qëllim që palët me interes të njihen me opinionet, përgjigjes së AKEP-it si dhe vendimit të tij lidhur me çështjen e nxjerrë për këshillim;
2. Propozimet e paraqitura nga Grupi i punës, lidhur me rishikimin e pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave dhe për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike, nëpërmjet projekt aktit për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike”, së bashku me pagesat që kryhen në AKEP për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike në zbatim të Rregullores nr. 20, “Mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të

komunikimeve elektronike”, përbëjnë paketën e akteve nënligjore mbi pagesat që kryhen në AKEP, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së AKEP, si organ rregullator në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, në zbatim të pikës 2 të nenit 119 të ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 si dhe pikave 12 dhe 17 të Rregullores,

V E N D O S:

1. Të miratojë publikimin e raportit të AKEP, mbi procesin e Këshillimit Publik të përfunduar me palët e interes për dokumentin: “Mbi propozimin për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””.
2. Të propozojë për miratim pranë Këshillit të Ministrave projektvendimin dhe relacionin përkatës “ Për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””.
3. Ngarkohet Kryetari për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij;

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE

Përmbajtja

- 1. Hyrje**
- 2. Përmbledhje**
- 3. Çështjet e Këshillimit Publik**
 - 3.1 Propozimet e Pagesave per Spektrin e Frekuencave per Sherbimet Radio**
 - 3.1.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit.**
 - 3.1.2 Pyetja nr. 1, mendime të paleve me interes dhe qëndrimi i AKEP**
 - 3.1.3 Pyetja nr. 2, mendime të paleve me interes dhe qëndrimi i AKEP**
 - 3.2 Propozimi për Shërbimin Privat të lëvishëm Radio-PMR**
 - 3.2.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit**
 - 3.2.2 Pyetja nr. 3, mendime të paleve me interes dhe qëndrimi i AKEP**
 - 3.3 Propozimi për strukturën e Tabeleës dhe vlerat e pagesave për Shërbimin Fiks Radio**
 - 3.3.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit**
 - 3.3.2 Pyetja nr. 4, mendime të paleve me interes dhe qëndrimi i AKEP**
 - 3.3.3 Pyetja nr. 5, mendime të paleve me interes dhe qëndrimi i AKEP**
 - 3.4 Propozimi për ndryshimin ne Sherbimet Satelitore**
 - 3.4.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit**
 - 3.4.2 Pyetja nr. 6, mendime të paleve me interes dhe qëndrimi i AKEP**
 - 3.5 Propozimi për pagesate shërbimeve të tjera radio, leje dhe autorizime.**
 - 3.5.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit**
 - 3.5.2 Pyetja nr. 7, mendime të paleve me interes dhe qëndrimi i AKEP**
 - 3.5.3 Pyetja nr. 8, mendime të paleve me interes dhe qëndrimi i AKEP**
 - 3.6 Propozimet për pagesat e caktimit dhe përdorimit të numrave dhe Serive Numerike**
 - 3.6.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit**
 - 3.6.2 Pyetja nr. 9, mendime të paleve me interes dhe qëndrimi i AKEP**

1. HYRJE

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare-AKEP, me 28 Qershor 2012, publikoi per keshillim publik dokumentin “Mbi propozimin për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimn e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike”(me tej Dokumenti).

Qellimi i ketij keshillit publik ishte qe AKEP per te njihej me pikepamjet e paleve te interesuar ofrues te sherbimeve te komunikimeve elektronike, mbi propozimet per strukturen e llogaritjes dhe nivelin e pagesave vjetore per perdorimin e spektrit te frekuencave per shërbim fiks radio, perfshirjen ne tabelat perkatese te pagesave te brezave te rinj frekuencash si dhe per përdorimin e numrave dhe serive numerike.

AKEP ne propozimet e dhena pervec sa eshte permendur ne dokumentit e Keshillimit Publik, ka patur qellim qe shumta e te ardhurave nga keto pagesa te jene te mjaftueshme per shpenzimet administrative te vete institucionit si percakton dhe ligji Nr. 9918 date 19.05.2008.

AKEP ne perfundim te periudhes se keshillimi publik, ka marr pergjigjet, verejtjet dhe sugjerimet, nga palet e interesuara, dhe pas shyrtymit me pergjegjisi te tyre, percakton qendrimin e tij per to’.

Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 119 përcakton të gjitha llojet e pagesave që kryhen në AKEP. Dokumenti i keshillimit publik “Mbi propozimin për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimn e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””, ka të bëjë vetëm me pagesat që bëhen në AKEP, sipas pikes 1.c dhe 1,ç te atij neni.

Megjithatë, AKEP vlerëson mendimet, sugjerimet dhe opinionet e sipërmarresve, në përgjigje të këtij këshillim publik edhe për pagesat, që nuk kanë qënë objekt i tij, por që lidhen me të ardhurat e AKEP, apo dhe për tarifën e shërbimit të radiokomunikacionit që janë pagesa, të cilat nuk përfshihen në planin e shpenzimeve të AKEP. Nisur nga fakti se palët me interes kanë dhënë verejtje dhe mendime lidhur me pagesat për përdorim dhe tarifatat për shërbimin radio, duke i trajtuar ato si pagesatë dyfishta, për mos publikim e planit të shpenzimeve, sqarojmë sa vijon:

Në dokumentin e këshillimit publik, kemi pasur si qëllim disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimn e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike”, lidhur me uljen deri në 30% të pagesave për dhënien dhe përdorimin e frekuencave, duke u bazuar në:

- Nxitjen e një mjedisi më të favorshëm, jo diskriminues me synimin e përafrimit me raportet e vendeve të Rajonit dhe të BE;
- Eksperiencën e dy viteve të fundit, mbi menaxhimin e spektrit të frekuencave, të cilën e karakterizon dinamika e lartë e ndryshimeve dhe inovacionit të teknologjisë së komunikimeve elektronike;
- efektivitetin dhe parimin e mosdiskriminimit.

Buxheti i AKEP përbëhet nga pagesat sipas nenit 119 te Ligjit nr.9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në R.SH”. Sipas përlloraritjeve paraprake, pjesën më të madhe të buxhetit të AKEP (rreth 70%), do t’u financojnë arkëtimet nga pagesat që do të kryejnë sipërmarrësit për përdorimin e frekuencave radio. Pjesa tjetër do të arkëtohet nga pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike. Llogaritjet për këto pagesa do të bëhen duke zbatuar nenin 24 te Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, dhe Rregulloren “Mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.1170, datë 19.02.2010.

Përsa i përket mënyrës së mbajtjes së llogarive në kontabilitet, ndarjes dhe publikimit të tyre në kuadër të transparencës me palët me interes, AKEP dëshiron t’ju garantojë se:

1. Plani i shpenzimeve të AKEP, hartohet sipas nevojave të institucionit për shpenzime administrative dhe investime, me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale për mbikqyrjen dhe rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike. AKEP bën kujdes që pagesat e sipërmarrësve të përlligjin plotësisht këtë buxhet duke mos lejuar devijime dhe abuzime. Si institucion i pavarur, AKEP, planifikon të ardhurat në të njëjtin nivel me shpenzimet që ka planifikuar për vitin kalendarik.

Zërat përbërës të buxhetit të AKEP-it, pasi argumentohen dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i AKEP, paraqitet në Ministrinë e Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit, më pas miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe lidhja bashkëngjitur tij, parashikon zërat:

- Paga
- Sigurime shoqërore dhe shëndetsore
- Materiale
- Shërbime dhe,
- Investime

me vlerën në lekë si dhe shumën totale.

2. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare si organ rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, çdo vit raporton në Kuvendin e Shqipërisë mbi veprimtarinë e tij. Pjesë e raportimit janë dhe realizimi i treguesve financiarë. E parë në këtë aspekt të gjithë sipërmarrësit mund të marrin informacion lidhur me shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve që programohen dhe realizohen nga AKEP.

3. Së fundmi, strukturat e AKEP në bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit, në draftin e përgatitur për ndryshimet në Ligjin nr. 9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, kanë parashikur shtimin e një pike në nenin 119 me nr.4, me përmbajtjen si më poshtë:

“AKEP-i në zbatim të parimit të transparencës, çdo vit publikon një përmbledhje të llogarive të përdorura dhe të përfundimeve, sipas bilancit financiar vjetor që depoziton në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim”.

2. Përmbledhje

Në zbatim të Vendimit nr. 2113, datë 28.06.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP gjate periudhës së Këshillimit Publik “Mbi propozimin për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimn e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike”, kanë paraqitur zyrtarisht përgjigjet mbi pyetjet e ngitura në AKEP mbi dokumentin për Këshillim Publik Sipërmarrësit, si më poshtë:

- Albanian Mobile Communications sh.a me anë të shkresës nr. 1351/3 prot, datë 26.7.2012;
- Baits sh.p.k me anë të shkresës nr. 793/3 prot, datë 18.7.2012;
- Operatori B Communication sh.a me anë të shkresës nr. 1536 prot, datë 26.07.2012;
- Operatori C sh.a me anë të shkresës nr. 1598 prot, datë 31.07.2012;

AKEP, falenderon operatorët e cituar me sipër për përfshirjen me komentet e tyre në dokumentin për Këshillim Publik.

AKEP çmon që në lidhje me komentet e sipërmarrësve dhe qendrimin e AKEP mbi keto komente, të ndiqet struktura si më poshtë:

- pyetjen e hartuar nga AKEP ne konsultim publik;
- komentet/pergjigjet e secilit operator mbi kete pyetje, si dhe
- qendrimin e mbajtur nga AKEP per komentet përkatëse.

Gjatë periudhës së Këshillimit Publik nuk pati asnjë pyetje apo kërkesë për sqarim nga palët me interes. Operatorët e shërbimeve dhe të rrejteve të komunikimeve elektronike publike, i janë përgjigjur pyetjeve në dokumentin për konsultim publik për:

- Brezat e frekuencave që përdoren për shërbimet publike të lëvizshme të komunikimeve elektronike;
- Brezat e rinj të frekuencave për shërbimet e levizshme te komunikimeve elektronike duke parashikuar dhe pagesat vjetore për ta;
- Lidhjet fikse radio P-P dhe P-MP;
- Për heqjen e pagesave për ato shërbime radio që nuk do të apikohen në të ardhmen;
- Disa ndryshime mbi pagesat për numrat dhe seritë numerike.

3. ÇESHTEJET E KESHILLIMIT PUBLIK.

3.1 Propozimet e Pagesave per Spektrin e Frekuencave per Sherbimet Radio

3.1.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit

Dokumenti i keshillimit publik permban ndryshimin e pagesat vjetore per brezat e frekuencave që përdoren për shërbimet publike të lëvizshme të komunikimeve elektronike, duke i ulur ato ne masen 30% dhe shtimin e brezave te tjere te frekuencave per kete sherbim radio, bashke me pagesat vjetore.

3.1.2 Pyetje Nr. 1

Cili është mendimi Juaj në lidhje me propozimet për zvogëlimin e pagesave për brezat e frekuencave radio që janë në përdorim (Nr. rendor 3 deri 6)?

Mendime te palëve me interes:

Komenti i Operatorit A

Operatori A mbështet iniciativën e AKEP për uljen në masën 30% të pagesave për përdorimin e frekuencave radio në shërbimet ekzistuese publike celulare GSM, UMTS.

OPERATORI A shpreh rezervë vetëm për brezat e pacifitezuara UMTS (Nr. 6) për të cilat sugjerojmë një ulje me të ndjeshme për arsye të përdorimit të tyre shumë me të vogël krahasuar me brezat UMTS të çiftuar.

Megjithatë duhet të themi se AKEP në këtë dokument nuk ka specifikuar se ku është bazuar në përcaktimin e nivelit të këtyre pagesave.

Komenti i Operatorit B

OPERATORI B shpreh vlerësimin dhe mbështetjen e tij për hartimin dhe publikimin për konsultim të këtij dokumenti. Gjithashtu mbështet qëllimin e AKEP për të ndryshuar pagesat për të nxitur një mjedis me të favorshëm, jo diskriminues për shërbimet e komunikimeve elektronike, dhe synimin e përafritimit me raportet e vendeve të Rajonit dhe të BE.

OPERATORI B vlerëson faktin se, AKEP në propozimin për ndryshime në VKM nr. 599 ka konsideruar në përgjithësi uljen e pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike. Një pjesë e mirë të sipërmarresve të rrjeteve dhe shërbimeve telekomunikimit elektronik, ju duhet të kryejnë një sërë pagesash në AKEP qoftë për frekuencat, qoftë për seritë numerike, të cilat në total shkojnë drejt vlerave kostove realisht të konsiderueshme, ndaj një qëndrimi i tillë i AKEP është i mirëpritur.

Komenti i Operatorit C

Operatori C mbështet propozimin e AKEP për të përfshirë breza të rinj frekuencash dhe vlerëson se pagesat e propozuara janë të drejta dhe në proporcion me vlerën e brezave të frekuencave në përdorim. Operatori C vlerëson se ky ndryshim do t'u lejojë operatorëve të rrjeteve të

komunikimeve elektronike shfrytëzimin më efektiv të spektrit të frekuencave si dhe do të rrisë konkurrencen në tregun e komunikimeve elektronike.

Megjithatë Operatori C mendon se ka vend që këto pagesa të zvogëlohen edhe shume me tepër, nëse do të zbatohet pagesa për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.

Qendrimi i AKEP.

Nisma e AKEP për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike” ne masen rreth 30% te pagesave aktuale, ka patur parasysh që te ardhurat nga keto pagesa dhe ato te mbikqyrjes se tregut te mbulojne shpenzimet administrative si percakton dhe Ligji nr. 9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Sugjerimi per ulje te metejshme te pagesave vjetore per keto breza frekuencash nuk mund te meret ne konsiderate.

3.1.3 Pyetja Nr.2

Cili është qendrimi juaj për pagesat e propozuara për brezat e frekuencave që përfshihen rishtas (Nr. Rendor 1, 2 dhe 7 deri 9)?

Mendime të palëve me interes

Komenti i operatorit A

Lidhur me pagesat e propozuara per brezat e frekuencave qe përfshihen rishtas (Nr. Rendor 1,2 dhe 7 deri ne 9), OPERATORI A mendon se do te ishte i nevojshem qe materiali i konsultimit publik te permbante dhe nje informacion te plote mbi parashikimet e AKEP per menyren e perdorimin e ketyre brezave, kohen kur mendohet te tenderohen dhe arsyeja e diferences se madhe ne pagesa (me te larte) te brezave ne 450-470 MHz dhe 790-880 MHz.

Ne emertimin e paragrafit 2.1. do te sugjeronim zevendesimin e fjales "telefonik" pasi sherbimet e reja celulare tashme, sic edhe dihet, nuk transmetojne vetem ze.

Komenti i operatorit B

OPERATORI B vlereson faktin se AKEP ne propozimin per ndryshime ne VKM Nr. 599 ka konsideruar ne pergjithesi uljen e pagesave per caktimin dhe perdorimin e frekuencave, te numrave dhe serive numerike. Nje pjese te mire te sipermarresve te rrjeteve dhe sherbimeve te komunikimeve elektronike, ju duhet te kryejne nje sere pagesash ne AKEP qofte per frekuencat, qofte per serite numerike, te cilat ne total shkojne drejt vlerave dhe kostove realisht te konsiderueshme, ndaj nje qendrimi i tille i AKEP eshte i mirepritur.

Komenti i Operatorit C

Operatori C vlerëson propozimin e AKEP, për të përfshirë breza të rinj frekuencash si dhe janë të mendimit se pagesat e propozuara janë të drejta dhe në propocion me vlerën e brezave të frekuencave në përdorim. Megjithatë nuk është dhënë asnjë sqarim nga AKEP për mënyrën se si do të shrytëzohen këto breza frekuencash dhe si do të bëhet ndarja midis shrytëzimit të televizioneve dhe të operatorëve celular, për këtë arsye Operatori C mendon se parashikimi i këtyre pagesave në VKM është e parakohshme dhe nuk mund të jape një qëndrim për vlerësimin e këtyre pagesave pa patur një shpjegim të plotë nga AKEP për mënyrën e shrytëzimit të brezave të rinj të frekuencave.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, bazuar ne Dokumentin e Politikave per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise, Kapitullit 7, miratuar me VKM Nr.322, date 5.5.2010, referuar perdorimit aktual te brezave te frekuences, percaktimeve te Radio Rregulloreve te ITU, Actit Final WRC-12, vendimeve dhe rekomandimeve te CEPT, arriti ne perfundim se jane mundesine e perdorimit te brezave 450 MHz, 800 MHz, 2,5 GHz dhe 3.5 GHz, per komunikimet elektronike me brez te gjere.

AKEP mundon se del jashte objektit te Dokumentit te keshillimit publik, perfshirja ne te', e informacionit per menyren e perdorimit te ketyre brezave dhe se kur do te tenderohen.

Megjithate, AKEP, lidhur me perdorimin e ketyre brezave mendon se mund tu referoheni raporteve, vendimeve dhe rekomandimeve te CEPT, qe gjenden ne faqen elektronike te Zyres Europiane te Komunikimit (European Communications Office), www.ecodocdb.dk.

Persa i perket kohes se tenderimit, ju bejme me dije se kjo lidhet me politikat e zhvillimit te sektorit te komunikimeve elektronike dhe se duhet te realizohet disponueshmeria e plote e ketyre brezave, qe kane qene perdorur per sherbimet e tjera radio.

AKEP, ne kohen e duhur do te jape informacionin e plote per perdorimin e ketyre brezave, ndarjen e kanaleve apo blloqeve, kerkesat dhe referencat teknike te perdorimit te tyre si dhe kohen e kushtet e tenderimit, sipas legjislacionit ne fuqi.

Pagesat e propozuara ne Dokumentin e Keshillimit Publik, per keto breza te frekuencave (450 MHz, 800 MHz, 2,5 GHz dhe 3.5 GHz), jane bazuar ne praktikat e vendeve europiane dhe ne cilesite teknike te ketyre brezave te spektrit te frekuencave.

AKEP mirekupton sugjerimin tuaj per heqjen e termit "telefonik".

3.2 Propozimi për Shërbimin Privat të lëvishëm Radio-PMR

3.2.1 Përmbledhje e temes së Këshillimit.

AKEP propozon shfuqizimin e Kategorisë 5, ne tabelen nr. 2 te VKM nr. 599

"Sistemi PMR në zonë shërbimi kombëtar për zonën e ofrimit të shërbimit më të madhe se 50 km, pagesa për çdo sistem është 100 000 lek".

3.2.2 Pyetje Nr. 3

Cili është mendimi juaj për këtë propozim, shfuqizimin e Kategorisë nr. 5, në Tabelën Nr.2 të VKM nr.599, dhe a keni mendim për ndryshime të tjera?

3.2.3 S'ka komente nga Sipërmarrësit.

3.3 Propozimi për strukturën e Tabelës dhe vlerat e pagesave për Shërbimin Fiks Radio

3.3.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit.

AKEP mendon të ruhet e njëjta tabelë për ndarjen e brezave të frekuencave dhe gjerësitë e kanaleve radio, dhe propozon ndryshimin e Tabelës Nr.3 të VKM Nr. 599, datë 23.07.2010.

3.3.2 Pyetja Nr. 4

A jeni dakort të ruhet e njëjta strukturë e tabelës së mësipërme lidhur me ndarjen e brezave të frekuencave radio?

Përgjigje e Operatorit A:

Operatori A është dakort me ruajtjen e strukturës së tabelës ekzistuese të ndarjes së brezave të frekuencave.

Përgjigje e Operatorit C:

Operatori C propozon ndryshimin e strukturës së tabelës lidhur me brezat e frekuencave, në bazë të arsytimit të mëposhtëm:

1. Performanca e brezit 1 - 10 GHz është më e superioare krahasuar me brezin nga 10 - 14 GHz. Performanca më e superioare është rezultat i karakteristikës së përhapjes dhe imunitetit nga shiu për spektrin poshtë pragut 10GHz. Rrjedhimisht propozohet që brezi 10 - 14 GHz të veçohet nga brezi 1-10 GHz dhe të bashkëngjitet me grupimin 14 -20 GHz.
2. Pragu $BW < 3.5$ Mhz krijon një mbivlerësim të spektrit për Mhz krahasuar me grupimet e tjera (psh për brezin 15GHz për kanalin me gjerësi 35Mhz rezulton një vlerë prej $35,000 / 3.5 = 10,000$ Leke për MHz, ndërsa për të njëjtin brez 15GHz me gjerësi kanali 14 Mhz rezulton një vlerë prej $45,000 / 14 = 3,215$ Leke; pra 1MHz është vlerësuar 3 herë më tepër në grupimin e parë me prag 3.5MHz).

Rrjedhimisht për të patur një vlerësim më proporcional dhe të drejtë të spektrit, propozohet për grupimin e parë një prag më i lartë deri në 7 MHz.

Sa më sipër, Operatori C propozon ndryshimin e strukturës së tabelës si poshtë:

Brezi frekuencave	Gjerësi kanali (BW)			
	$Bw \leq 7$ MHz	$7 < Bw \leq 20$ MHz	$20 < Bw \leq 40$ MHz	$BW > 40$ MHz
$f \leq 1$ GHz				
$1 \text{ GHz} < f \leq 10 \text{ GHz}$				
$10 \text{ GHz} < f \leq 20 \text{ GHz}$				
$20 \text{ GHz} < f \leq 37 \text{ GHz}$				
$37 \text{ GHz} < f \leq 39.5 \text{ GHz}$				
$f > 39.5 \text{ GHz}$				

Qëndrimi i AKEP:

AKEP , eshte dakort dhe i ka qarta argumentat lidhur me performancen e brezit (10-15) GHz te frekuencave, krahasuar me ate te brezit (1-10) GHz, por perdorimi kryesor i ketij brezi frekuencash eshte me kanale radio me kapacitet te larte transmetimi, njelloj si dhe ai i brezit (6-8.5) GHz, por ne distance me te vogel.

Gjithashtu duke konsideruar kerkesat e shumta per perdorimin e kanaleve radio, per lidhjet fikse Pike-Pike te ketyre brezave te frekuencave si dhe sherbimet e tjera radio ne keto breza frekuencash (lidhje radio Pike-Shume Pika, lidhje satelitore, pjese te brezit te harmonizuar per sisteme te mbrojtjes), mundesia e plotesimit e te gjitha ketyre kerkesave eshte e pamundur.

Lidhur me propozimin e dyte (eshte i te njejtit operator), per te ndryshuar ndarjen per gjeresite e kanaleve, sepse vlera per 1 MHz, per gjeresi kanali deri 3.5 MHz eshte 3 here me e madhe se ajo per gjeresi 7 MHz, sqarojme se:

Ky propozim te con ne stimulimin e perdorimit te lidhjeve fikse me gjeresi kanali 3.5 MHz dhe 7 MHz (me kapacitet transmetimi te ulet, deri 10 Mbit/s), ne brezat e frekuencave qe perdoren per kapacitete transmetimi te mesem (nga 10 deri 100 Mbit/s dhe te larte, mbi 100 Mbit/s). Pra ne perdorimin jo efektiv te brezit te frekuencave.

Llogaritjet e vleres se brezit, gjeresi 1 MHz, per te gjitha brezat e frekuencave, per kanalet me gjeresi 14 MHz, 28MHz dhe 56 MHz, rezulton se ndryshimet jane ne raport afersisht (1:1,6), ne sensin zvogelues.

AKEP, per arsyet e mesiperme nuk do te ndryshoje strukturen e pagesave (ndarja ne gjeresi kanali dhe brez frekuencash) per lidhjet fikse radio.

3.3.3 PyetjaNr.5

Cili është mendimi Juaj për vlerat e pagesave të propozuara?

Përgjigje e Operatorit A:

OPERATORI A shprehet dakort, me uljen e propozuar ne vlerat e pagesave per frekuencat e perdorura ne lidhjet fikse radio, megjithate do te sugjeronim te perfshihej ne material nje shpjegim i arsyeve per uljet jo te njejta te pagesave, te cilat variojne nga 20-40%.

Përgjigje e Operatori B:

OPERATORI B vlereson faktin se AKEP ne propozimin per ndryshime ne VKM nr. 599 kakonsideruar ne pergjithesi uljen e pagesave per caktimin dhe perdorimin e frekuencave, te numrave dhe serive numerike. Nje pjese te mire te sipermarresve te rrjeteve dhe sherbimeve tekunikimit elektronik, ju duhet te kryejne nje sere pagesash ne AKEP qofte per frekuencat,qofte per serite numerike, te cilat ne total shkojne drejt vlerave dhe kostove realisht te konsiderueshme, ndaj një qendrimi i tillë i AKEP është i mirëpritur.

Përgjigje e Operatorit C:

Operatori C eshte dakord me vlerat e pagesave te propozuara.

Qëndrim i AKEP:

AKEP vlereson verejtjen e operatorit per kete ceshtje dhe sqaron se:

- Pagesat per lidhjet fikse radio ne brezat e frekuencave nga (1- 39.5) GHz, ku jane dhe numri me i madh i lidhjeve fikse radio, jane zvogeluar ne masen nga (33.3 – 40) %, me qellim zvogelimin e ndjeshem te ngarkesave financiare te perdoruesve te ketyre brezave.
- Pagesat per lidhjet fikse radio, ne brezat e frekuencave me te larte se 39.5 GHz, jane zvogeluar ne masen 20-25%. Lidhjet radio ne keto breza frekuencash jane te pakta, por dhe me pare kane qene te ulta, me qellim nxitjen e perdorimit te lidhjeve radio ne keto breza.

3.4 Propozimi për ndryshimin ne Sherbimet Satelitore

3.4.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit

AKEP, bazuar në Planin Kombetar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave, mendon të përfshijë në brezat e frekuencave dhe pjesën e brezit (14.25 deri 14.50) GHz, që përdoret për MSS, FSS,VSAT/SNG, me prioritet për rrjetet civile.

3.4.2 Pyelja nr.6

Cili është mendimi Juaj per kete ndryshim të propozuar tek Tabela Nr. 6 e VKM nr.599?

Përgjigje e Operatori C:

Operatori C eshte dakord me vlerat e pagesave te propozuara.

S'ka komente nga Sipërmarrësit e tjerë.

3.5 Propozimi për pagesa te shërbimeve të tjera radio, leje dhe autorizime.

3.5.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit

AKEP, propozon qe të hiqet *Pagesa vjetore për certifikatë konformiteti pajisjesh.*

3.5.2 Pyetja nr.7

Cili është mendimi Juaj per kete ndryshim tek Tabela Nr. 9, e VKM Nr. 599?

Përgjigje e Operatorit A:

Operatori A shprehet dakort me propozimin e AKEP per shfuqizimin e pikes 4.2 te tabelës nr.9 te VKM Nr.599, ne lidhje me pagesen per certifikaten e konformitetit per pajisjet fundore ngasubjektet jo tregtare vendase.

S'ka komente nga operatorët e tjere.

3.5.3 Pyetja nr.8

A mendoni se duhen bere ndryshime të tjera për pagesat që përmban Tab. Nr.9, e VKM Nr.599?

S'ka komente nga Sipërmarrësit.

3.6 Propozimet për pagesat e caktimit dhe përdorimit të numrave dhe Serive Numerike

3.6.1 Përmbledhje e Temave të Këshillimit

Dokumenti per Keshillim Publik permban propozimet mbi ndryshimet per pagesat e caktimit dhe përdorimit te numrave dhe serive numerike.

3.6.2 Pvetje nr. 9

Cili eshte qendrimi juaj mbi keto propozime dhe a mendoni se duhen bërë ndryshime të tjera?

Përgjigje e Operatorit A:

Arsyet e ndryshimeve te propozuara nga AKEP per nivelin e pagesave vjetore ne lidhje me numeracionin nuk jane shprehur dhe AKEP nuk ka percaktuar nje formule per llogaritjen e tyre. Si per frekuencat, edhe pagesat per caktimin dhe perdorimin e numeracionit jane te lidhura me shpenzimet administrative te AKEP per administrimin e tyre, ndaj ato duhet te jene te

mbeshtetura ekskluzivisht mbi keto shpenzime. Publikimi i buxhetit të AKEP për këto qëllim është i domosdoshëm në mënyrë që keto përcaktimi tyre të jetë sa më transparent për operatorët dhe i mbështetur në kosto reale dhe të justifikuar.

Në lidhje me propozimet e AKEP për ndryshimet në pagesat për numeracionin, OPERATORI A shpreh komentet e saj si më poshtë:

a- Ulja e nivelit të pagesave për numrat jo-geografike është parimisht një hap pozitiv por jo i mjaftueshëm, pasi nuk janë përcaktuar kriteret dhe mënyra se si është bërë llogaritja për uljen e këtyre pagesave, si dhe nuk ka një referencë për të parë nëse keto nivele pagesash janë proporcionale në lidhje me shpenzimet përkatëse të AKEP për këto qëllim në mënyrë që të reflektojnë plotësisht keto kosto.

b- Edhe për rritjen e pagesave për kodet e aksesit për bartesin, për ISPC, për kodet e rrjetit mobile *MCC/MNC* dhe për transmetimin e të dhenave DNIC nuk ka informacion se si janë përcaktuar kriteret si dhe mënyra se si është bërë llogaritja për këto levizje. AKEP ka propozuar një rritje të nivelit të pagesave për keto kategori *par* nuk jep shpjegime ku është bazuar.

c- Me specifikisht për kodet *MCC/MNC*, OPERATORI A është kundër pageses për keto kode, pasi ato planifikohen dhe caktohen nga LTU, dhe si të tilla nuk lidhen me shpenzimet administrative të AKEP për këto qëllim.

Përgjigje e Operatorit C:

Operatori C vlerëson se, AKEP propozon dyfishimin e tarifave për Kodin e Pikes Nderkombetare të Sinjalizimit - ISPC, dhe Kodin e Rrjetit Mobile - *MCC/MNC*, nderkohe që nuk jep asnjë sqarim për nevojën e rritjes së këtyre tarifave. Keto tarifa paguhen në AKEP çdo vit dhe dyfishim i tyre përben një barër financiare për operatorët. Si rrjedhim, Operatori C kundërshton rritjen e tarifave ISPC dhe *MCC/MNC* pa asnjë arsye të vlefshme.

Përgjigje e Operatorit B:

Operatori B është dakort me ndryshimet e pagesave në Tabelën Nr. 10 të VKM Nr. 599, datë 23.07.2010, përveç ndryshimit me rritje të Tarifës për kodet ISPC dhe *MCC/MNC*. Lidhur me rritjen e propozuar për pagesat e këtyre dy kodeve, vërejmë se nga AKEP nuk është dhënë një argument konkret. Për pagesat e Tabelës 10, AKEP i ka propozuar ndryshimet "*bazuar në krahasimin e pagesave vjetore për përdorimin e numrave dhe serive numerike (perdisa nga rregullaloret e rajonit)* si dhe nga eksperiencia e dy viteve të fundit ... ", por nuk jep detaje specifike për secilën pagesë, apo referencë në pagesat e vendeve të tjera.

Operatori B nuk është dakort me ndryshimin e propozuar për pagesat e këtyre kodeve e sidomos me rritjen dyfish të tyre:

Tarifa për ISPC është rritur nga 50,000 leke në 100,000 leke

Tarifa për MCC/MNC është rritur nga 50,000 leke në 100,000 leke

Operatori B aktualisht ka 2 (dy) kode ISPC dhe 1 (një) kod *MCC/MNC* dhe nominalisht është kosto e shtuar për çdo vit. Nga ana tjetër, me rritjen e aktivitetit, kërkesa për keto kode/numra mund të rritet dhe keto kode/numra janë të domosdoshëm për adresimin e një platforme të një rrjeti telekomunikacioni, duke qenë se me të behet e mundur komunikimi ndërrjetor për rrugëzimin e thirrjeve. Pra nuk janë kode/numra për të cilët një sipërmarrës do të vlerësojë nëse do të marrë dhe paguajë në AKEP, por nëse kërkon të ushtrojë/zgjerojë aktivitetin për të cilin

është autorizuar i duhet patjetër të marrë kode të tilla. Në këtë këndvështrim, nga AKEP duhet të justifikohet dhe jepen argumenta bindës për rritjen e pagesës së tyre. Lidhur me sa më sipër, Operatori B sugjeron të mos ketë një rritje për këto kode ose minimalisht rritja të mos jetë në nivelin dyfish, sikundër është propozuar nga AKEP.

Përgjigje e Operatorit D

Nisur nga eksperiencat tona në treg dhe si një nga sipërmarresit e autorizuar nga AKEP kërkojmë të propozojmë që pika 6 e tabelës 10 të VKM të rishikohet dhe të ndryshohet duke aplikuar një tarifë vjetore prej 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekesh, e cila do të ishte e barabartë me vlerën 1.000 Leke në muaj për çdo subjekt.

Propozimin e ndryshimit të kësaj tarifë në e mbështesin në argumentat më poshtë:

- Operatori D sikurse beson se mjaft subjekte të tjera që fillojnë të operojnë në fushën e shërbimeve me vlerë të shtuar VAS, përballen me mjaft kosto investimi për ngritjen e shërbimeve të tyre, si edhe me kostot promovuese të shërbimeve që duhet të hidhen në treg. Në këto kushte pagesa e tarifës (tarifave) vjetore që i duhen paguar AKEP në momentin e aplikimit për një kod të shkurter apo për disa kode njekohesisht janë vlera të cilat prekin ndjeshëm buxhetin e një biznesi fillestar. Nisur nga fakti që subjektet të cilat synojnë të maksimizojnë përdorimin e këtyre kodeve të shkurtra janë pikerisht subjektet ofrues të shërbimeve me vlerë të shtuar, atëherë një kosto me e ulët se 20.000 Leke që është aktualisht, drejt një shifre prej 12.000 Lekesh do të ndihmonte mjaft në përdorimin e këtyre fondeve për me shumë aktivitete promovuese.

Nisur nga fakti që tashmë aplikimi për Autorizim Individual nga ana e AKEP është mundësuar online dhe sipas tendencave të punës suaj, edhe aplikimi për kode të shkurtra dhe seri numerike (tepaktën VAS) do të mundësohet së shpejti online, kjo do të sillte edhe reduktimin e kostos së AKEP për caktimin e këtyre kodeve të shkurtra subjekteve sipërmarres. Duke u reduktuar kosto e AKEP atëherë do të mund të krijohet edhe mundësia që të reduktohet pagesa vjetore për këto kode të shkurtra nga 20.000 Leke aktualisht në 12.000 Leke.

- Së fundmi, sigurisht që një çmim më i ulët do të gjeneronte edhe me shumë aplikime nga sipërmarres apo subjekte që në të kaluarën mund të jenë stepur edhe nga çmimi i aplikuar për tarifën vjetore, duke sjellë kështu rritjen e konkurrencës në këtë segment të tregut dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për klientin.

Qëndrimi i AKEP:

Ndryshimet e propozuara për “Pagesat për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”, në dokumentin e paraqitur për konsultim publik, sipas Vendimit nr.2113, datë 28.06.2012, janë bazuar kryesisht në:

1. Praktikën e rregullatoreve të rajonit për pagesat për përdorimin vjetor të numeracionit,
2. Politiken rregullatore të AKEP për sa i përket trafikut ndërkombëtar,

3. Eksperienca e AKEP nga aplikimi i VKM nr.599, date 23.07.2010.

Ketu nuk behet fjale qe rritja per pagesat per numeracionin do te rrisë buxhetin e AKEP duke renduar mbi buxhetin vjetor te kompanive. Buxheti i AKEP mbetet i njejte(sipas planifikimit vjetor), por ne keto raste behet vetem rishperndarje e pagesave qe kompania kryhen ne AKEP per pagesat per perdorimin e frekuencave dhe numeracionit.

Pra neqoftese do te hiqej pagesa per numeracionin, kjo vlere e munguar do te kalonte ne rritjen e pagesave per perdorimin e frekuencave, dhe anasjelltas, mbasi vlere totale e pagesave vjetore mbetet e pandryshuar.

Aplikimi i pagesave per perdorimin e frekuencave dhe numeracionit kryesisht kushtezohet nga fakti qe ato jane burime te fundme dhe duhet te mire administrohen dhe te perdoren me eficence.

Zbatimi i VKM nr.599, date 23.07.2010(per pagesat ne AKEP), sipas te cilit u aplikua per here te pare pagesa per perdorimin vjetor te numeracionit(me pare per numeracionin paguhej vetem nje here nje vlere fillestare dhe per numra te veçante nuk paguhej fare), i cili u shoqerua me kerkesa per anulim numeracioni nga operatore te ndryshem, ka treguar se shume operatore ne aplikimet per numeracionin nuk kane qene racional ne kerkesat e tyre.

Per sa i perket pagesave per kodet e aksesit per bartesit, per ISPC, per kodet e rrjetit mobile MCC/MNC per transmetimin e te dhenave DNIC, te gjithë rregullatorët e konsultuar aplikojne pagese per perdorim vjetor te tyre(duke filluar nga 100.000 leke deri ne 360.000 leke).

Në lidhje me komentën e operatorit D per rishikim të pagesave per kodet e shkurter AKEP arsyeton se:

Se pari duhet te kemi parasysh qe numrat e shkurter SMS VAS bejne pjese ne numeracionin qe perdoret nga ofruesit e Sherbimeve me Vlere te Shtuar, megjithate pagesa per perdorimin vjetor eshte me e ulet ne krahasim me grupin e numrave jo-gjeografike per ofrimin e sherbimeve te ndryshme.

Se dyti pagesa per perdorimin vjetor te numrave te shkurter SMS VAS eshte aplikuar per here te pare me zbatimin e VKM nr.599, date 23.07.2010 dhe sot ne regjistrin e sipermarresve qe ofrojne Sherbime SMS me Vlere te Shtuar jane te regjistruar 32 sipermarres qe kane ne perdorim 153 numra te shkurter SMS VAS dhe ky eshte i vetmi propozim per uljen e pageses vjetore te perdorimit.

Se treti, fakti qe edhe aplikimi per numra dhe seri numerike do te mundesohet se shpejti on-line, mund te reflektuje ne uljen e pageses per caktimin e numrave(sot 1.000 Lek dhe paguhet vetem nje here)dhe jo ne pagesen per perdorimin vjetor qe kryesisht kushtezohet nga fakti qe ato jane burime te fundme dhe duhet te mire administrohen dhe te perdoren me eficence.